



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-041
Prishtinë, më 3 shtator 2018, në orën 8:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 SHTATOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Sasha Milosavljeviq, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Kërkesa e 51 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për seancë të jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 51 deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga grupet parlamentare LDK, VV dhe PSD kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit për datën 4 shtator 2018, me këtë rend dite: *Debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e shkëmbimit të territorit apo korigjimit të kufijve në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë*

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, njëzëri vendosi që Kuvendi të mbajë seancë të jashtëzakonshme të martën, më 4 shtator 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e shkëmbimit të territorit apo korigjimit të kufijve në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

2. Njoftim i deputetëve Mimoza Kusari-Lila dhe Ilir Deda

Kryetari i njoftoi të pranishmit se deputetët e Kuvendit, zonja Mimoza Kusari-Lila dhe Ilir Deda, kanë njoftuar se nuk janë më pjesë e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe se punën e tyre në Kuvend do ta zhvillojnë si deputetë pa grup parlamentar.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 8:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale